

VENDIM
Nr. 761, datë 12.11.2014

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 637, DATË 21.5.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT QYTETAS TË
UDHËTARËVE, TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR. 146, DATË 26.2.1998, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, shkronja “c”, e 14, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe të neneve 121, pika 1, e 124, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 637, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit qytetas të udhëtarëve, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”.

2. Tarifat e miratuara me vendimin nr. 637, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, do të vazhdojnë të zbatohen deri në çastin e miratimit të tarifave nga këshilli bashkiak përkatës, në përputhje me nenet 10 e 14, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, por jo më shumë se një muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama